



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 14.12.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 12.12.2023 të parashtruar nga Operatori ekonomik “PE -VLA-KU” SH.P.K. DEGA NË KOSOVË, lidhur me aktivitetin e prokurimit me “ Ri-tender -Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-13225-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-004 -511, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: ““PE -VLA-KU” SH.P.K. DEGA NË KOSOVË, e dt.12.12.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-tender -Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-13225-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-004 -511, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë të AK –së, të datës 24.11.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË e publikuara me datë: 24.11.2023;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “PE -VLA-KU” SH.P.K. DEGA NË KOSOVË, me dt.12.12.2023, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-tender -Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-13225-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-004 -511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 14.12.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj është i pabazuar, sepse Autoriteti kontraktues, të gjitha iso dhe mostrat e kërkuara nga Autoriteti kontraktues, janë në harmonizim të LPP-së.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

